



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 800/8 Prot.

Durrës, më 5.3.2025

VENDIM

Nr. 21, datë 5.3 2025

PËR

"DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" ZNJ. RIMA DIJKSTRA"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", kreu V, neni 1; të shkresës Nr. 625/1 Prot., datë 19.02.2025 të Rektorit "Mbi dhënie e titullit "Doctor Honoris Causa", për Znj. Rima Dijkstra, Koordinatorë e Përgjithshme dhe anëtare e Komitetit Drejtues të Projektit të Aleancës Universitare STARS EU", si dhe të shkresës së MAS Nr. 1265/2 prot, datë 03.03.2025, në mbledhjen e datës 05.03.2025, Senati Akademik:

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit "Doctor Honoris Causa" Znj. Rima Dijkstra nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, me motivacionin: "Për punën e shkëlqyer dhe ndikimin e jashtëzakonshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në rolin e Koordinatorës së Përgjithshme dhe Drejtueses së Komitetit Drejtues të Aleancës Universitare "STARS EU", me kontributin e vyer në forcimin e marrëdhënieve midis UAMD-së dhe tetë universiteteve partnere evropiane, duke ndikuar rrënjësisht në strategjinë afatgjatë të kërkimit shkencor, mësimdhënies, qëllimit për arritjen e diplomave të përbashkëta, rritjes së kapacitetit akademik, shkëmbimit të stafit akademik e studentor, krijimit të bashkëpunimit të shumëanshëm dhe zhvillimit strategjik të UAMD-së si edhe atë ndërrajonal e ndërkombëtar, duke nxitur dhe frymëzuar evropianizimin dhe transformimin e arsimit të lartë".
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtoria e Projekteve dhe Mardhënieve me Jashtë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

